



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 10.10.2024
NR.09/8364 /2024

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-24-10209-2-4-7/C567& KKHE(VM) 24-045-2-4-7

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Dafina Karahoda, Fehmi Lladrovci, 20000, Prizren, me ID. **1008192622**, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), me profesion inxhinierë e diplomuar e arkitekture do të jete i angazhuar në DUKMM- -si konsulet për draftimin e PZHK-së për një afat prej pesëmbdhjetë (15) ditëve, në anën tjetër në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Shërbime konsulente për DUKMM-në për draftin e PZHK-së pjesa e parë KKHE(VM) 24-045-2-4-7 me numër identifikues: 659-24-10209-2-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Shërbime konsulente për DUKMM-në për draftin e PZHK-së pjesa e parë KKHE(VM) 24-045-2-4-7

No.	Lot
1	Shërbime konsulente për DUKMM-në për draftin e PZHK-së pjesa e parë KKHE(VM) 24-045-2-4-7

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : **990.00**; € [Nëntqind e nentdhjetë Euro /00 cent - paga bruto] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën: dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush Bajramaliu
Pozita:	Zyrtar i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10.10.2024
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Dafina Karahoda
Pozita:	Konsulente
Nënshkrimi:	
Data:	10.10.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-10209-2-4-7/C567

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. <i>Gjykta Themelore ne Ferizaj Dega ne Kaçanik</i>
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është [10.10.2024] .
	6.4	Data e Përfundimit është [25.10.2024] .
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>[Komuna Hani i Elezit DUKMM-ja -]</i> .
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[N/A]</i> .
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[0.25%]</i> në ditë per shërbime te përealizuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[10%]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <i>N/A</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>[shëno shumën]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>[Pagesa do te behet pas realizimit te shërbimit – dorezimin draftit te PZHK-se dhe trajtimin e komenteve dhe permiresimet ne PZHK. Sipas kapitujve]</i> <i>Pagesa do te behet brenda afati ligjor]</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[[Konsulent i-e Jashtëm-e për nevojat e Drejtorisë Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) respektivisht për angazhimin per trajtimin e komenteve dhe permiresimet ne draftin e PZHK-së sipas kapitujve : 1.Pjesa tekstuale 2.Profili komunale]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>Gjykta Themelore ne Ferizaj Dega ne Kaçanik</i> b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .